

# KONTROLI I LINDJES DHE TRANZICIONI I LINDSHMËRISË: SHEMBULLI I KOSOVËS (BIRTH CONTROL AND TRANSITION: THE KOSOVO EXAMPLE)

Mimoza DUSHI

Departamenti i Gjeografisë, FSHMN, Universiteti i Prishtinës, Kosovë

E-mail: [mdushi@fshmn.uni-pr.edu](mailto:mdushi@fshmn.uni-pr.edu)

## PËRMBLEDHJE

Femra është aktori kryesor në procesin e lindshmërisë dhe qëndrimet e saj mbi mënyrën individuale të sjelljes riprodhuese kanë ndikim në trendet e fertilitetit në nivel shoqëror. Për të studiuar sjelljen riprodhuese të femrës në shoqërinë kosovare dhe për të shpjeguar qëndrimet dhe mendimet personale të tyre rreth lindshmërisë, u shfrytëzuan të dhënat empirike të mbledhura në Qendrën Universitare Spitalore në Prishtinë. Nëpërmes saj është arritur të shihen disa aspekte të planifikimit të familjes, përkatësisht kontrollit të lindjes dhe përdorimit të mjeteve dhe metodave kontraktive në shoqërinë kosovare. Në këtë punim vështrohet për së afërmi roli i femrës në përtëritjen e gjinisë njerëzore dhe gatishmëria e saj për të kontrolluar riprodhimin e vet. Varësisht nga moshja, kohëzgjatja e jetës martesore, niveli i shkollimit, i punësimit dhe tipi i vendbanimit do të shqyrtohet deri në çfarë niveli janë femrat kosovare sot të vetëdijesuar për problemin e riprodhimit.

**Fjalët kyçe:** femra, lindshmëria, kontrolli i lindjes, faktorët influencues

## ABSTRACT

Woman is the main actor in fertility process

and her attitudes toward individual reproductive behavior has effect in the fertility trends in social level. To study reproductive behavior of woman in kosovar society and to explain her attitudes and personal opinion about fertility are used empiric data collected in University Hospital Centre in Prishtina. Through it we investigated some aspects of family planning, respectively birth control and the usage of contraceptive methods in kosovar society. In this paper is examined the woman's role in biological renewal and her willingness to control its reproduction. Depend on age, length of marriage life, level of education, employment and type of dwelling will see the level of consequences of kosovar woman today about reproductive problems.

**Key words:** woman, fertility, birth control, influential factors

## HYRJE

Popullata qysh herët ka kërkuar mënyra dhe mjete për shfrytëzimin e kapacitetit fiziologjik të lindshmërisë, ta mbisundojë riprodhimin e vet përmes kontrollit të lindjes, duke filluar nga përdorimi i metodave dhe mjeteve tradicionale deri te ato moderne. Ndër mjetet moderne janë kontraktivët, përdorimi i të cilëve varet jo vetëm

nga dëshira e njerëzve për kontrollin e lindjes dhe kufizimin e lindshmërisë, por edhe nga cilësia e shërbimeve për planifikimin e familjes. Niveli i përdorimit të tyre ka ndikim të drejtpërdrejt në nivelin e fertilitetit dhe përmes kësaj në shkallën e rritjes së popullsisë së një vendi. Kontraceptivët kryesisht përdoren për parandalimin e shtatzanisë, që lindjet të mos jenë shumë të hershme, shumë të vonshme, në intervale të shkurtra, si dhe të ruajnë shëndetin e nënës dhe fëmijës. Ky tregues është i lidhur ngushtë me faktorët e tjerë si mosha e popullsisë, pjesëmarrja e femrës në punësim dhe niveli i zhvillimit të vendit në përgjithësi.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të shihet gatishmëria e femrës në shoqërinë kosovare për të kontrolluar riprodhimin e vet; të shihet lidhja midis përdorimit të kontraceptivëve sipas llojeve, njohurive për ta dhe mënyrës së furnizimit, varësisht nga mosha e femrës, statusi martesor, niveli i shkollimit, punësimi dhe vendbanimi; dhe për më tepër të ofrojë interpretimin e këtyre variablave. Që të arrihet ky objektivi, studimi fokusohet në dy aspekte kryesore:

- a. krijimi i metodologjisë së punës duke u bazuar në të dhënat, dhe
- b. prezantimi i rezultatit përfundimtar

#### METODOLOGJIA E PUNËS

Modeli i studimit për këtë hulumtim u bazua në teorinë se çdo sjellje njerëzore mund të jetë e vetëdijshme dhe e planifikuar. Me fjalë të tjera njerëzit veprojnë në mënyrë të arsyeshme, duke llogaritur informatat e mundshme që gjenden dhe problemet që mund të rrjedhin nga sjellja e tyre (Ajzen, 1991). Nisur nga kjo, në këtë hulumtim kontrolli i lindjes është konsideruar si një mënyrë e sjelljes riprodhuese që kryhet nga njerëzit me qëllim të planifikimit të familjes. Se si aplikohet kjo dhe sa është e aplikueshme në shoqërinë kosovare, janë analizuar të gjithë faktorët që mund të kenë ndikim në të dhe janë ndarë në dy grupe. Në grupin e parë hyjnë qëndrimi ndaj mënyrës së sjelljes (mendimi mbi pasojat); normat e jashtme (mendimet e të tjerëve mbi sjelljet e tua) dhe burimet e mundshme (prania e faktorëve që mund të ndihmojnë në sjelljen përfundimtare) dhe në grupin e dytë janë faktorët e jashtëm që ndikojnë

në të: mosha, vitet e martesës, niveli i shkollimit, punësimi dhe vendbanimi. Po ashtu, duke pasur parasysh që për të vlerësuar pasojat e sjelljes, negative apo pozitive, personi duhet të ketë njohuri për pasojat e asaj sjelljeje, modelit të studimit në këtë hulumtim i është shtuar edhe një element, njohuria.

Metodologjia e punës dhe veprimi me variablat e modelit të studimit është bërë duke u bazuar në të dhënat e këtij studimi që janë marrë nga një hulumtim empirik i realizuar në Klinikën gjinekologjike të Qendrës Universitare Spitalore në Prishtinë, prej muajit shtator 2006 deri në muajin mars 2007. Gjatë kësaj periudhe kanë qenë nën vëzhgim gratë në periudhën fertile, mosha 15-49 vjet, të cilat pritin të kryenin lindje apo kishin kryer lindje (normale apo cezariane). Të dhënat janë mbledhur me anë të anketimit, me rreth 1000 gra të pyetura.

#### REZULTATI

Pas gjithë këtyre përgatitjeve rreth krijimit të modelit të studimit, përfshirjes së variablave, punimit me to dhe analizës vijmë deri te rezultati për faktorët që ndikojnë në përdorimin e kontraceptivëve.

Përgjigjet lidhur me nivelin e njohurisë krijojnë mangësi në analizën e mirëfilltë të kësaj variable sepse nuk ofrojnë një pasqyrë të qartë për njohurinë reale mbi kontraceptivët (mungon njohuria mbi mënyrën e përdorimit, kohëzgjatjen e përdorimit, kudërefektet, etj). Dosido përkundër kësaj, bazuar në të dhënat e shfrytëzuara, del se në Kosovë 93.8% e femrave në periudhën fertile kanë dëgjuar për të gjitha metodat kontraceptive, përfshirë edhe ato moderne. Por, nëse e krahasojmë këtë rezultat me nivelin e përdorimit, atëherë gjejmë një mospërputhje mjaft të madhe midis tyre që vjen si rezultat i mënyrës tradicionale të jetës në shoqërinë kosovare. Prej të gjitha femrave të përfshira në hulumtim 66.9% kanë përdorur kontraceptivë. 78.6% kanë përdorur marrdhënien e ndërprerë (*coitus interruptus*), e cila bën pjesë në metodat tradicionale që nuk konsiderohen si shumë të sigurta, ndërsa metodat moderne edhe pse njihen si metoda më të sigurta, përdoren nga një numër i vogël grash. Ndër to më të përdorshmet janë kondomi, spiralja

dhe pilulat të cilat shpesh herë janë përdorur në kombinim me metodat tradicionale (Figura 1).




Figura 1. Përqindja e metodave më të përdorura kontraceptive në Kosovë, 2007

Në lidhje me çështjen e dytë, variablat që ndikojnë në përdorimin e kontraceptivëve, janë analizuar në gjithë personat që mund të kenë ndikim te gratë për planifikimin e familjes dhe u ndanë në dy grupe. Së pari është analizuar ndikimi i bashkëshortit dhe së dyti janë analizuar ndikimet e të tjerëve. Nga analiza e pjesës së parë del se mbi 70% e grave të përfshira në hulumtim diskutojnë me bashkëshortët e tyre për çështjet rreth planifikimit të familjes dhe mjetet e kontrollit të lindjes, por prej tyre vetëm 30.7% i marrin vendimet bashkërisht. Ndërsa nga ndikimi i të tjerëve, shokët apo të afërmit janë të parët me të cilët bisedohen këto çështje, pastaj vijjnë motra, kunata, vjehrra, nëna dhe të tjerët. (Figura 2)




Figura 2. Niveli e diskutimit të planifikimit të familjes me të tjerët, 2007

Pjesë shtesë e së njëjtës pyetje është edhe mënyra e furnizimit me kontraceptivë, bazuar në tri vende furnizimi, si sektori publik (spitalet dhe ambulancat), sektori privat (klinikat private dhe barnatoret) dhe të gjitha burimet e tjera (shokët apo të afërmit). Te kjo del se më se gjysma e të anketuarave i marrin kontraceptivët nga shokët apo

të afërmit, që mund të jetë vetëm këshillë dhe e arsyeton nivelin e lartë të përdorimit të metodave tradicionale në Kosovë.

Duke vazhduar analizat mbi ndikimin e faktorëve të jashtëm gjejmë se femrat e moshuara dhe të martuara përdorin më shumë kontraceptivë se sa femrat e moshës së re. Kjo mund të jetë rezultat i asaj se ato që kanë arritur numrin e dëshiruar të fëmijëve fillojnë të përdorin mjetet e ndryshme për të kufizuar apo ndërprerë lindjet. Këtë e dëshmon rritja e shkallës së përdorimit të kontraceptivëve pas moshës 35 vjeç, ku më se 70% e grave deklaruan se marrin masa mbrojtëse.

Përsa i përket viteve të martesës, del se numri më i madh i lindjeve është i përqendruar në vitet e hershme të saj, veçanërisht në pesë vitet e para. Prandaj edhe përdorimi i kontraceptivëve në këtë kohë pothuajse mungon fare. Deri diku është i pranishëm përdorimi i metodave tradicionale. Pas kësaj, femrat me 6-10 vjet martesë fillojnë të kombinojnë metodat tradicionale me ato moderne, veçanërisht me kondomin, kurse pas 10 vjet martesë fillojnë të përdorin spiralen apo pilulat.

Gjithashtu, gjejmë se femrat e shkolluara dhe të punësuara përdorin me shumë kontraceptivë se sa ato të pashkolluara ose me nivel të ulët shkollimi dhe të papunësuara. Siç duket rezultatin e analizës së raportit të nivelit të shkollimit dhe kontraceptivëve, e ka diktuar numri i femrave për secilën kategori, mirëpo ajo që mund të komentohet te kjo analizë është niveli i përdorimit brenda secilës kategori veç e veç. Sipas kësaj del se të gjitha femrat me shkollim të lartë të përfshira në hulumtim, përdorin kontraceptivë, ato me përgatitje universitare afër dy të tretat, me shkollë të mesme më pak se gjysma, ndërsa e kundërta është tek ato me nivele më të ulëta shkollimi, me shkollë jo të plotë fillore që pothuajse nuk përdorin fare kontraceptivë. Kur zberthehet ky rezultat për secilën metodë kontraceptive, del se përveç ndërprerjes, femrat e pashkolluara dhe ato me nivele më të ulëta shkollimi preferojnë spiralen, ato me nivel të mesëm shkollimi preferojnë spiralen, kondomin dhe injeksionet, kurse ato me shkollim të lartë preferojnë pilulat kontraceptive dhe abstenimin, që hyn në metodat tradicionale.

Pak a shumë i njëjti rezultat është edhe te anal-

iza e variablës së punësimit. Në kategorinë e femrave të punësuar numri i atyre që përdorin mjetet e kontrollit të lindjes është 2.6 herë më i lartë se sa tek ato që nuk përdorin. Kjo ndodh për shkak se femrat e punësuar, edhe pse në një masë jo të kënaqshme, e kanë më të vështirë t'i lënë aktivitetet e jetës së përditshme për lindjen dhe rritjen e fëmijëve. Prandaj edhe anojnë më tepër nga planifikimi i familjes. Duke vështruar këtë rezultat për secilën metodë kontrceptive, dallimi në mes këtyre dy kategorive të femrave është më i dukshëm. Ndër metodat moderne më të përdorura te femrat e papunësuar është spiralja dhe injeksionet, ndërsa te të punësuarat janë pilulat dhe abstenimi.

Si variabël tjetër është edhe vendbanimi, ku dallimi nuk është aq i madh te niveli i përdorimit të kontraktivëve se sa te metoda më e përdorur. Përveç ndërprerjes dhe kondomit, të cilat përdoren te të dy kategoritë, rezultati del se femrat e vendbanimeve rurale preferojnë më shumë spiralën dhe injeksionet, ndërsa ato të vendbanimeve urbane preferojnë abstenimin.

Nga të tre këto variabla, shkollimi, punësimi e vendbanimi del se spiralja është metoda më e preferuar nga femrat me status të ulët shoqëror, ndërsa abstenimi te ato me status më të lartë shoqëror. Nga rezultati i deritashëm për abstenimin, është parë se edhe pse është metodë tradicionale e kontrollit të lindjes, femra duhet të ketë njohuri paraprake mbi procesin e riprodhimit dhe ndryshimet në trupin e saj gjatë kësaj periudhe që të arrijë ta përdorë, përkatësisht aplikojë atë.

#### PËRFUNDIM

Qëllimi i këtij punimi është vështrimi i sjelljes riprodhuese të femrës në shoqërinë kosovare; më qartë të shihet lidhja në mes përdorimit të mjeteve të kontrollit të lindjes sipas llojeve dhe faktorëve të jashtëm.

Si rezultat parësor del se niveli i përdorimit të kontrollit të lindjes në shoqërinë kosovare nuk është në një nivel të kënaqshëm. Për më tepër, shkallë më të lartë përdorimi kanë mjetet tradicionale në krahasim me ato moderne. Kjo dëshmon se femra në shoqërinë kosovare ende nuk ndihet plotësisht e aftë që të vendosë vetë për numrin e pasardhësve që do t'i ketë dhe të arrijë kështu të

kontrollojë riprodhimin e vet. Përveç bashkëshortit që ka ndikimin kryesor, shpeshherë edhe rrethi shoqëror është ai që përfshihet në planifikimin e familjes. Kjo shihet edhe te vendi i furnizimit me mjete të kontrollit të lindjes, ku për pjesën më të madhe të femrave është shoqëria. Kjo dhe niveli i lartë i përdorimit të mjeteve tradicionale kontrceptive na shtyn të mendojmë se është fjala vetëm për këshilla. Këto fakte dëshmojnë shkallën e lartë të tradicionalizmit në shoqërinë kosovare, për të cilën nevojitet investim dhe kohë që të ndryshohen qëndrimet ndaj sjelljes riprodhuese.

Pas këtyre, u analizuan edhe faktorët e jashtëm. Si rezultat i parë te kjo analizë gjejmë se ndikimin më të madh në përdorimin e kontraktivëve e ka moshja, statusi martesor dhe vitet e martesës. Femrat e moshuara dhe ato që janë të martuara për një periudhë më të gjatë kohore, përdorin më shumë kontraktivë se sa femrat e moshës së re dhe të sapomartuara. Për më tepër, këto janë edhe preferuese më të mëdha të metodave moderne kontrceptive, veçanërisht spirales. Ky rezultat na shtyn të mendojmë se femrat e pamartuara i frikësohen përdorimit të kontraktivëve, posaçërisht atyre modernë, me faktin se mund të kenë pasoja në shtatzaninë e tyre të ardhshme. Kjo ndodh për shkak të mosinformimit, informimit të pamjaf-tueshëm apo të gabuar rreth kontraktivëve dhe mënyrës së përdorimit të tyre. Në anën tjetër, përdorimi i kontraktivëve nga femrat në moshë të shtyrë dëshmon se ato e kanë arritur numrin e dëshiruar të fëmijëve dhe kërkojnë të ndjehen më të sigurta në parandalimin e shtatzanive të tyre të ardhshme.

Gjithashtu prej analizave të variablave socio-ekonomike, gjejmë se femrat e shkolluara dhe të punësuar përdorin më shumë kontraktivë se sa ato të pashkolluara ose me nivel të ulët shkollimit dhe të papunësuarat. Kësaj i përgjigjet edhe rezultati mbi tipin e vendbanimit. Femrat që jetojnë në qytet përdorin më shumë kontraktivë se sa ato që jetojnë në fshat. Femrat e shkolluara (me nivele të larta të shkollimit) dhe të punësuarat të cilat kanë arritur të sigurojnë një bazë ekonomike, pa dyshim se ndjehen më të pavarura dhe marrin pjesë aktive në çështjet mbi planifikimin e familjes. Te kjo kategori femrash vërehet një shkallë më e

lartë e koordinimit të kohës të cilën ajo planifikon ta kalojë në punë dhe me familjen.

#### BIBLIOGRAFIA

AJZEN, I. (1991), The Theory of Planned Behaviour. *Organizational Behaviour and Human Decision Process* 50, pp. 179-211.

ISLAMI, H. (1997), *Dimensioni demografik i çështjes së Kosovës*. Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Ko-

sovës, Prishtinë, Kosovë.

ISLAMI, H. (2005), *Studime demografike. 100 vjetët e zhvillimit demografik të Kosovës*. Academia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë, Kosovë.

*Kosova në shifra* (2008), Enti i Statistikës së Kosovës, Prishtinë.

Internet: <http://www.ks-gov.net/ESK>

UNFPA, SOK (2005). *Demographic, Social and Reproductive Health Situation in Kosovo: Result of a household Survey 2003*.

